



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15.07.2016

Ref.: 644/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 43-të, të mbajtur më 06 Korrik 2016, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet BPrAL Kolegji "AUK" në nivel institucional për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2016 - 30 shtator 2019.
- II. Obligohet BPrAL Kolegji "AUK" që deri më datë 1 tetor 2016 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.

A r s y e t i m i

BPrAL Kolegji "AUK" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim institucional. AKA ka organizuar vizitën në BPrAL Kolegji "AUK" më datë 12.05.2016, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Prof. Dr. Volker Gehmlich dhe Prof. Dr. Tanja Dmitrovic.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 06 Korrik 2016 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "AUK", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28.

Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "AUK"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë